

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri  
Veselit, RexhepSelimit dhe Jakup Krasniqit**

**Për:** Gjykatësin e Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr Fidelma Donlon

**Parashtrues:** Mbrojtësi i Kadri Veselit

**Data:** 3 maj 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për ndryshimin e  
numrit të lejuar të fjalëve**

---

**Zyrës së Prokurorit të  
Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Dejvid Hupër

**Mbrojtësi i Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagendra

## I. HYRJE

1. Në pajtim me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”), Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja”) kërkon ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve për t’ju kundërpërgjigjur përgjigjeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) ndaj mocioneve paraprake të parashtruara sipas rregullës 97(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”).

2. Më konkretisht, Mbrojtja kërkon shtimin e 4000 fjalëve për kundërpërgjigjen e saj ndaj Përgjigjes së ZPS-së KSC-BC-2020-06/F262 dhe shtimin e 4000 fjalëve për kundërpërgjigjen e saj ndaj Përgjigjes së ZPS-së KSC-BC-2020-06/F263.

3. Pas konsultimit të ZPS-së, ajo konfirmoi sot në mëngjes se nuk e kundërshton kërkesën.

## II. DISPOZITAT PËRKATËSE LIGJORE

4. Neni 42 i Udhëzuesit të Punës parasheh se kundërpërgjigjet ndaj përgjigjeve mbi mocione paraprake të parashtruara sipas rregullës 97(1), nuk duhen të jenë më shumë se 3000 fjalë.

5. Nenet 36(1) dhe 36(2) të Udhëzuesit të Punës parashohin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të urdhërojë ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve **i)** në rrethana të posaçme, **ii)** mjaftueshmërisht në kohë, **iii)** pasi janë dhënë arsye bindëse dhe **iv)** pa përgjigjen e palës kundërshtare, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare.

## III. PARASHTRIMI

*i) Rrethanat e posaçme*

6. Mocionet paraprake janë të parat në llojin e vet që parashtrohen para Dhomave

të Specializuara të Kosovës dhe trajtojnë çështje ligjore komplekse. Vendimet e marra mbi to do të krijojnë precedent mbi të cilin do të mbështeten çështje gjyqësore të tjera në të ardhmen.

*ii) Koha e parashtrimit të kësaj kërkesë*

7. Afati për dorëzimin e Përgjigjeve të ZPS-së ishte 23 prill 2021 dhe ato u njoftuan më 26 prill 2021. Afati për parashtrimin e kundërpërgjigjeve ndaj këtyre përgjigjeve është 14 maj 2021. Mbrojtja i shkroi ZPS-së më 30 prill 2021 për t'i kërkuar miratim në lidhje me shtimin e kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve. Mbrojtja ia parashtron kërkesën Gjykatësit të Procedurës Paraprake afërsisht rreth gjysmës së afatit të mbetur për parashtrimin e kundërpërgjigjeve të veta.

*iii) Arsyet bindëse*

8. Përgjigja e konsoliduar e ZPS-së lidhur me pikën e ndërmarrjes kriminale të përbashkët<sup>1</sup> përmban 67 faqe (23.870 fjalë) dhe përgjigja e saj ndaj kundërshtimit juridiksional në lidhje me zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare shkon në 48 faqe (15.935 fjalë).<sup>2</sup> Për shkak të kompleksitetit dhe vëllimit të përgjigjeve të ZPS-së, kërkesa për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve është e arsyeshme.

*iv) Mungesa e dëmit*

9. Siç u përmend më lart, më 30 prill 2021, Mbrojtja e njoftoi ZPS-në se do të kërkonte ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve. Për shkak se kundërpërgjigjet e Mbrojtjes do të kufizohen vetëm në kundërshtimin e parashtrimeve të ZPS-së, kapitull pas kapitulli, dhe në to nuk do të paraqiten parashtrime të reja, nuk do të shkaktohet asnjë dëm.

#### IV. PËRFUNDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Mbrojtja i kërkon me respekt Gjykatësit të

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06/F00263

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06/F00262  
KSC-BC-2020-06

Procedurës Paraprake të urdhërojë ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve, sikurse kërkohet në paragrafin 2 më lart.

**Numri i fjalëve (në origjinal): 461**

/nënshkrimi/

**Ben Emerson, CBE QC**

nënshkrimi/

**Nikola Kaufman**

**Mbrojtës i specializuar i Kadri Veselit Bashkëmbrojtës i Specializuar i Kadri Veselit**

3 maj 2021